



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembl*

---

**Legjislatura V**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr. 05

Prishtinë, më 10.2.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione

**Në mbledhje morën pjesë:** Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Valdete Bajrami dhe Kujtim Paqaku.

**Munguan:** Jasmina Zhivković dhe Etem Arifi.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Reshit Gashi, koordinatori i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit- UNICEF.

**I ftuar:** Sami Kurteshi-Avokat i Popullit.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Edona Tolaj-YIHR, Agron Demi-GAP, Diana Berisha-FIQ, Dren Doli-GLPS, Selvet Gerxhaliu-GDNJD, Selma Seković-OSCE dhe Lejla Selimi-OSBE.

**Mbledhjen e kryesoi,** Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.03/2015;
3. Ecuritë aktuale në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në Kosovë ( I ftuar për këtë pikë të rendit të ditës është Avokati i Popullit z. Sami Kurteshi.);
4. Shqyrtimi i Peticioneve;

5. Të ndryshme.

**Kryetarja** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

#### **1.Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

#### **2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.03/2015;**

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 26.1.2015, u miratua pa vërejtje.

#### **3.Ecuritë aktuale në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në Kosovë ( I ftuar për këtë pikë të rendit të ditës është Avokati i Popullit z. Sami Kurteshi.);**

Kryetarja tha se për këtë pike të rendit të ditës e kemi ftuar Avokatin e Popullit, z. Sami Kurteshi dhe e falënderoj që ju ka përgjigjur ftesës së komisionit për ta njoftuar komisionin lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

**Sami Kurteshi Avokat i Popullit**, fillimisht i falënderoi anëtarët e komisionit për ftesën që i është bërë. Është një fillim i mirë i kësaj legjislature që ka ndërmarrë nisma që të bashkëpunojë menjëherë me institucionin e Avokatit të Popullit. Edhe me legjislaturën e kaluar kemi pasur marrëdhënie relativisht të mira dhe kontakte të vazhdueshme të komunikimit. Puna jonë kryesore është në pranimin e kërkesave, ankesave të njerëzve që kanë ndonjë mosmarrëveshje me institucionet e Republikës së Kosovës, tha Kurteshi . Në përgjithësi e kemi një rritje të vazhdueshme të numrit të ankesave në 5 vitet e fundit. Jemi duke punuar në raportin e vitit 2014 dhe sigurisht do të kemi statistika të tjera. Marrë në tërësi, numri më i madh i ankesave paraqitet kundër ekzekutivit dhe gjykatave. Ai tha se IAP-i, ende gjendet ne objekt privat. Kemi pasur premtime se ky problem do të zgjidhet por ende nuk është zgjidhur. Kemi 8 zyra regjionale, në Prizren, Pejë, Gjiilan, Mitrovicë, veriun e Mitrovicës , Graçanicë, Ferizaj dhe Gjakovë. Gjendja nuk është e njëjtë në të gjitha zyrat regjionale. Disa funksionojnë me nga një bashkëpunëtor e disa me nga dy, dhe shumica e këtyre zyrave janë të pa papërshtatshme për punë dhe personat me aftësi të kufizuara.

Çdo veprim në zyrën e IAP-it është e digjitalizuar. Një rast normal që hapet në IAP trajtohet dhe përfundohet brenda një kohe prej më pak se një muaj. Shumë ankesa që marrim kanë të bëjnë me çështjen e alimentacionit dhe problemet me pronën.

Kurteshi tha se është i gatshëm të përgjigjet në pyetjet të cilat do t'i shtrojnë anëtarët e komisionit.

**Lirije Kajtazi, kryetare,** tha se a do të kalojnë raportet e vitit 2013 në Kuvend apo vetëm ato të vitit 2014, duke përfshi edhe raportin e Avokatit të Popullit, për këtë do të vendosë Kryesia e Kuvendit.

**Mytaher Haskuka** tha se rritja e numrit të ankesave dhe e kërkesave në IAP është pozitive sepse tregon se po bëhet një punë e mirë. Çka duhet të bëjë Kuvendi që këtij institucioni ti jep më shumë pavarësi që t'ju ndihmojë në efikasitetin e punës suaj, dhe pse është një numër i madh i ankesave i papranueshëm nga IAP-i.

**Kujtim Paqaku** falënderoi IAP-in edhe për raportin e paraqitur në gjuhën rome. Jeni prej institucioneve të para që keni aplikuar edhe gjuhën rome, tha ky dhe pyeti se çka u bë me mbylljen e kampit në veri të Mitrovicës dhe çka është bërë me ata rom ashkali dhe egjiptas të dëbuar nga ato kampe, çka ndodhë me ata të helmuar që vdesin nga sasia e tepërt e helmit në gjak? Nuk kemi asnjë informatë lidhur me ta, ku OBSH-ja reagon për personat që kishin plumb të tepruar në gjak, dhe a keni pasur ndonjë kërkesë që në panelin gjyqësor të jetë edhe ndonjë rom, sepse të akuzuarit rom kanë të drejtë të mbrohen në gjuhën e tyre.

**Salihe Mustafa** u tha se rastet që janë të pranueshme nga IAP-i, pastaj bëhen hetime për to. A keni staf të mjaftueshëm për të bërë këtë dhe a mendoni se ka mungesa ligji, a duhet të plotësohet dhe ndryshohet ligji, dhe a do të kishin kontribuar këto ndryshime në funksionimin më të mirë të IAP-it.

**Mexhite Topalli** pyeti se a keni pasur ndonjë kërkesë nga qytetarët e Ferizajt, lidhur me rastin e punëtorëve të Fabrikës së Gypave në Ferizaj dhe çfarë veprime keni ndërmarrë. Sa i përket parkut të Brezovicës, a keni ndonjë ankesë që ajo pronë e shtetit të shfrytëzohet nga qytetarët pa pagesë?

**Teuta Haxhiu** tha se pajtohet me atë që ka evidentuar IAP-i, se në maje të korrupsionit është politika dhe motor që e mbanë gjallë krimin e organizuar janë policia, gjyqësia dhe prokuroria.

Haxhiu tha se i intereson të dijë se cilat janë rekomandimet që kishin ndihmuar në radhë të parë presidenten që ka formuar një Këshill antikorrupcion dhe nuk dihet se çka është bërë në atë drejtim. Deri më tash tha Haxhiu, nuk ka pa asnjë rezultat se ka ndryshuar diçka për të mirë, pra cilat janë rekomandimet e IAP në këtë drejtim, pyeti ajo.

**Sami Kurteshi** tha se e kemi bërë një raport dy vite më parë për institucionet e Kosovës. Kemi staf të mjaftueshëm për rastet që paraqiten në IAP. Të gjitha departamentet kërkojnë edhe resurse njerëzore edhe financiare, por do të bëjë përpjekje që në mënyrë racionale të caktojme numrin e njerëzve që merren me këto çështje. Kosova është ndër vendet e para në region, që e ka ligjin kundër diskriminimit prej vitit 2004 dhe vetëm një rast i diskriminimit është trajtuar në gjykatat e Kosovës dhe se ai rast është fituar dhe atë e ka paraqitur në gjykatë IAP-i, kundër Universitetit të Prishtinës.

Kurteshi tha se i kanë bërë dy raporte, lidhur me kampet në veriun e Mitrovicës, sa i përket sasisë së plumbit dhe këto raporte i ka dorëzuar në Kuvend dhe në Qeveri. Këto dy kampe janë mbyll dhe në Leposaviq janë edhe disa familje, për 6 familjet në kampin e Plemetinit, tha se nuk jam i njoftuar. Nuk kemi bërë kërkesë të hapur, që në panelet gjyqësorë të ketë rom. Është e drejtë e garantuar që komunikimi në gjykata të bëhet në gjuhën e kuptueshme.

Ai tha se duhet bërë ndryshimin e ligjit të Avokatit të Popullit dhe duhet kujdes shumë i madh në atë drejtim. Sa i përket punëtoreve të Fabrikës së Gypave të Ferizajt, Kurteshi tha se e kemi nxjerrë raportin dhe kemi kërkuar nga Qeveria dhe nga AKP-ja, që vendimi i gjykatës që garanton marrjen e të ardhurave, të zbatohet. Për parkun në Brezovicë, tha se nuk kemi reaguar si institucion. Kemi marrë ankesa nga personat që u janë rrënuar vilat në Brezovicë, i kemi hetuar ato dhe disa nga to kanë qenë të pabazuara dhe nuk i kemi pranuar sepse kanë qenë pa leje.

Nuk e kemi hetuar rastin e kryetarit të Shtëpcës, për ndërtimin e kasolles për inkasimin e parave sepse për këtë nuk e kemi pasur asnjë ankesë.

Kurteshi tha se nuk kemi bërë rekomandime për presidenten, sa i përket krimit dhe korrupsionit. Ne jemi që të forcohen institucionet e pavarura dhe ato të kryejnë punën e vet pa ndërhyrje politike.

**Kryetarja** tha se shqetësimet e juaja janë edhe shqetësimet tona. Është obligim yni të jemi afër me të gjitha institucionet që rekomandimet e IAP-it t'i marrin seriozisht.

#### **4. Shqyrtimi i Peticioneve;**

Kryetarja tha se më herët kemi shqyrtuar peticionin kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike. Pas dëgjimit të dy palëve, e pamë të nevojshme për të hulumtuar më shumë që të jemi korrektë. Ajo konstatoi se komisioni njëzëri vendosi të nxjerrë këtë:

##### **Rekomandim**

Kryesia e Kuvendit, konform nenit 15.8, të Rregullores së Kuvendit, në njërën nga mbledhjet plenare të radhës, ta radhit si pikë të veçantë të rendit të ditës, debatin parlamentar, lidhur me Peticionin Nr.01/2015, kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike.

Kryetarja tha se kemi edhe përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, që e ka ngarkuar komisionin tonë ta shqyrtojë peticionin e qytetarëve të Rahovecit për zbardhjen e fatit të Ukshin Hotit dhe shtoi se për këtë peticion do të vendosim në mbledhjen e radhës, dhe do të formojmë një grup të punës që fillimisht të shqyrtojë këtë peticion.

Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

##### **Përfundim**

Formohet grupi i punës për shqyrtimin e peticioneve në këtë përbërje:

Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka dhe Kujtim Paqaku.

## **5.Të Ndryshme.**

Kryetarja Lirije Kajtazi tha se nga OSBE-ja më datën 18, do të organizohet një trajnim sa i përket intervistimit për zgjedhjen e kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit.

Selma Zeković tha se jeni në dijeni se OSBE-ja përkrah IAP-in për vite të tëra, është me rëndësi që zgjedhja e Avokatit të Popullit në mënyrë të duhur është shumë e rëndësishme dhe me pajtimin e komisionit kemi vendosur t'ju organizojmë një trajnim më 18 shkurt 2015. Trajnimi do të mbahet në Hotel Emerald, në orën 10:00 deri në orën 16:00.

Trajnuesja është Jasminka Xhumhur, është avokate e Popullit në Bosnje dhe ka eksperiencë mbi 25 vjeçare kurse 6 vitet e fundit është Avokate e Popullit në Bosnje e Hercegovinë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

---

Lirije Kajtazi